

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti për Krime të Rënda, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Artan Sejrani si kryetar i trupit gjykues, si dhe gjyqtarët Xheladin Osmani dhe Nazim Vllaqo si anëtarë të trupit gjykues, me procesmbajtësen Florije Kolukaj, sekretare juridike pranë kësaj gjykate, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit E. S. nga fshati ..., Komuna e Dragashit, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KP-së, duke vepruar sipas aktakuzës së prokurorisë themelore në Prizren – departamenti i krimeve të rënda PP/I.nr.77/17 të datës 31.07.2017, në shqyrtimin gjyqësor, në prezencën e të akuzuarit E. S., mbrojtësit të tij avokatit H. K. nga Prizreni dhe përkthyeses gjyqësore Violeta Celina, në mungesë të prokurorit të shtetit, më datë 26.01.2018, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

E. S., nga i ati Z., dhe e ëma R., e lindur S., i lindur ... në Dragash, me vendbanim në fshatin ... Komuna e Dragashit, i martuar, babë i 3 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, ish zëvendës komandant i stacionit policor në Dragash, i gjendjes së mesme ekonomike, goran, shtetas i Republikës së Kosovës.

Në kuptim të nenit 364 parag. 1 nën parag. 1.3 të KPP-së:

LIROHET NGA AKUZA

Në cilësinë e personit zyrtar duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar nuk e përmbush detyrën zyrtar të tij me qëllim që të përfitoj dobi personit tjetër, në atë mënyrë që me datën 01.06.2017, rreth orës 11:00, në fshatin B. – Komuna e Dragashit, duke udhëhequr patrullën policore në përbërje prej 9 zyrtarëve policor me mision zbatimin e urdhër arrestit të gjykatës themelore në Prizren PED.nr. 48/17 të datës 02.03.2017, për dërgim në vuajtje të dënimit me burgim të gjykuarit M. Q., me të njëjtin e bisedon çështjen e arrestimit të tij dhe kur i gjykuari hynë në shtëpi me pretekst që të përgatitet përfiton nga rasti për tu fshehur e pastaj në funksion të arrestimit të tij nuk e urdhëron patrullën për ta bastisur shtëpinë dhe objektet përcjellëse, përkundrazi pa lenë patrullë për ta vëzhguar shtëpinë e të gjykuarit e urdhëron ekipin policor për tu larguar nga vendi i ngjarjes.

Këso dore do të kishte kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KP-së.

- Pasi që nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – departamenti i krimeve të rënda, ka parashtruar aktakuzën PP/I.nr.77/17 të datës 31.07.2017, kundër të akuzuarit E. S. nga fshati ..., Komuna e Dragashit, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KP-së.

Prokurori i shtetit Metush Biraj në fjalën përfundimtare ndër të tjera ka deklaruar se nga të gjitha provat që u administruar në këtë gjykim konsideron se i akuzuari E. S. është kryerës i veprës penale për të cilën është akuzuar. Nga provat e shoshitura përmes deklaratave të policëve në cilësinë e dëshmitarëve dhe nga vetë deklaratat e të akuzuarit, rezulton se me pa mëdyshje i akuzuari E. S. me dt. 01.06.2017, e ka udhëhequr aksionin për zbatimin e urdhër arrestit të gjykatës themelore në Prizren PED.nr.48/2017 të datës 02.03.2017, me qëllim të arrestimit të të gjykuarit M. Q. dhe dërgimin e tij në vuajtje të dënimit. Se gjatë zbatimit të aksionit në shtëpinë e të gjykuarit në fshatin B. ka hasur në rezistencë me armë nga ana e të gjykuarit, se me të gjykuarin M. e ka diskutuar mbi gjysme ore ene dorëzimit të tij pa prezencën e policëve, se disa minuta pas përfundimit të bisedës me të gjykuarin, policëve ua ka komunikuar se e paska mashtruar M. dhe paska ikur, se me policët e ka bërë një bastisje rutinore në stallë ku nuk e kanë hasur të gjykuarin, se në shtëpi dhe aneksin e shtëpisë nuk kanë kryer bastisjes, se gjatë tërheqjes nga vendi i ngjarjes me ekipin policor, nuk ka caktuar ndonjë patrullë policore me e vëzhguar, vëzhgimin e situatës në dhe rreth shtëpisë së të gjykuarit. Nga deklaratat e dëshmitarëve M. Q. dhe M. T. nuk vërtetohet fakti se i akuzuari E. S. me policët ka kryer bastisjen në stallë, në shtëpi dhe në aneks të shtëpisë të të gjykuarit për me tepër i gjykuari në fjalë këtu dëshmitari M. thekson se ka qenë i fshehur në stallë dhe se po te kishte ndodhur bastisja atëherë me siguri do ta hasin. I akuzuari thekson se para se tua komunikonte kolegëve policë se paska qenë i mashtruar dhe kinse paska ikur i gjykuari M., ai vetë e paska kontrolluar stallën e pastaj me vonë edhe me policët e paska kontrolluar stallën e njëjtë. Për organin e akuzës kjo mbrojtje është mjaftë e dyshimtë aq me tepër kur thekson arsyeja pse me policët para se të tërhiqet nga vendi i ngjarjes nuk ka bërë kontrole në shtëpie dhe në aneks se të gjykuarit. Konsideron se gjykata vërtetë e ka të qartë se i akuzuari me qëllim dhe dashje direkte për dobi të tjetrit në këtë rast të gjykuarit M. pas bisedës së gjatë të bërë vetëm me të gjykuarin janë marrë veshë ku me një kontrole sa për sy e faqe, por pa kontrole të shtëpisë dhe aneksin e saj e sidomos pa lënë patrullë të policisë afër shtëpisë së të gjykuarit është larguar nga vendi i ngjarjes. Prandaj gjykatës i propozon që i akuzuari të shpallët fajtorë dhe të gjykohet në bazë të ligjit.

Mbrojtësi i të akuzuarit E. S. av. H. K. në fjalën përfundimtare ndër të tjera ka deklaruar se përkitazi me aktakuzën e ngritur kundër të akuzuarit për veprën penale keqpërdorimi apo autoritetit zyrtar nga neni 422 parag. 1 te KP-së, e njëjta nuk është provuar pas administrimit të provave të propozuara në këtë aktakuzë, dëgjimit shtesë të bashkëshortes së dëshmitarit të propozuar M. Q., M. T. ku në bazë të deklarimeve të dëshmitarëve duke potencuar pozitën dhe rolin e tyre se janë zyrtar policor dhe duke dashur që deklaratat e tyre të merren me seriozitet të lartë dhe kredi bile nga fakti se janë persona me përgjegjësi të veçanta e të cilët bashkë me këtu të akuzuarin me dt. 01.06.2017 kanë marrë pjesë në zbatimin e urdhrat për arrestimin e të dënuarit M. Q., person i cili për stacionin policor në Dragash i njohur si refuzues i urdhrave dhe paraqitjes vullnetare për vuajtje të dënimit njëherit duke patur parasysh aktgjykimin dënues që i njëjti ka pasur problem me zyrtarët policor po të njëjtit stacion policorë që ky fakt tregon dispononim jo pozitiv të të dënuarit për të zbatuar urdhrat policore aq me tepër duke patur parasysh tentimet e shumë hershme nga policia në Dragash që ai të dorëzohet në zbatim të urdhrat për vuajtje të dënimit. Nga deklarimi i dëshmitarëve të propozuar dhe të

dëgjuar në këtë aktakuzë ka rezultuar se komandanti i policisë në Dragash Sh. U. ia jep për detyrë këtu të akuzuarit E. S. zbatimin e urdhrit i cili me përpikëri dhe profesionalizëm duke e respektuar rregullat policore duke u gjendur në një situatë të rrezikshme për vete dhe për kolegët e vetë, i gjendur para personit të dënuar me armë të repetuar dhe të gatshme që i njëjti eventualisht edhe mund të ketë gjuajtur edhe në zyrtarët policor, por njëkohësisht edhe zyrtarët policor për shkak të situatës së krijuar dhe ndjenjës para rrezikut të gjendur të një personi të rrezikshme i akuzuari përdor metoda të njohura me zbatimin e detyrës së punës duke dashur që pa dëme të zbaton këtë urdhër, dhe pranon që te negocion me te dënuarin për mënyrën e dorëzimit të tij, dhe assesi negocimin për t'ia lehtësuar ikjen e tij, këto fakte na kanë bindur me deklaratat e vetë zyrtarëve policor te cilët kanë qenë në afërsi te personave të cilët janë gjendur në atë situatë. Në fakte pas deklarimit të tij se do ti dorëzohet këtu të akuzuarit i njëjti e ven në mashtrim, e këtë mashtrim vetë i dënuari M. Q. e ka deklaruar se për kundër premtimit për dorëzim e ka tradhtuar këtu të akuzuarin, i cili shfrytëzon daljen nga kompleksi i banimit të shtëpisë së vetë dhe shfrytëzon daljen ku ka qenë e njohur për të dhe largohet në stallën e cila nga shtëpia e tij ka qenë prej 200-300 metra. Nuk qëndron pretendimi i prokurorisë se këtu i akuzuari nuk ka ndërmarre veprime për kontrollimin e objekteve në kuadër të shtëpisë e ku aty gjendet aneksi i asaj shtëpie të cilën edhe e ka kontrolluar për të gjetur të dënuarin. Nga këto që thash me lartë kërkoj nga gjykata që ndaj këtu të akuzuarit të merr aktgjykim lirues.

I akuzuari E. S. në fjalën përfundimtare ndër të tjera ka deklaruar se pajtohet në tërësi me fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij dhe shton se ku theksohet se jam lëshuar në negociata dua të them se është shumë me mirë që të negociosh deri 30-40 minuta, se sa të luftosh një minutë, me ka trajnuar nën koloneli nga Scotlanda i cili ka thënë se është më mirë një kriminel të jetë i lirë një ditë, një muaj edhe 20 vite se sa të pësoj një njëri i pa fajshëm, deklaroi me përgjegjësi duke shikuar nga aspekti policor nëse përsëri do të gjendem në situatë të njëjtë ku sipas situatës kërkohet që mos të ketë viktima njerëzore prapë do të veproja në mënyrë të njëjte.

Gjykata sipas detyrës zyrtare dhe atë konform nenit 257 të KPP është kujdesur lidhur me pranueshmerinë e provave dhe se në rastin konkret nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme në këtë çështje penale.

Për vërtetimin e gjendjes faktike gjykata i ka proceduar provat e propozuara nga palët dëgjimin e dëshmitarëve Sh. U., Sh. K., I. I., S. S., N. Q., H. S., L. B., Q. S., B. K., I. H., M. Q. dhe M. T. si dhe provat materiale Urdhër arresti i Gjykatë Themelore në Prizren PED.nr.48/17 të datës 02.03.2017, raportin njoftues të MPB-IPK, Departamenti i hetimeve në Prishtinë, me numër të protokollit 03-116-1263/16 të datës 14.07.2017, mbi rezultatin e raportit ligjorë të operatorit Vala, raporti i bastisjes të Njësisë së forenzikës të DRP në Prizren numër TK-053-2017 të datës 05.06.2017, raporti njoftues të MPB-IPK në Prishtinë me numër protokollit 02-116-1263/15 të datës 07.07.2017 mbi ekzaminimin e telefonave të sekuestruar me raportin e ekspertizës të telefonave dhe certifikatat mbi kthimin e telefonave të sekuestruara në pronësi të akuzuarit E. S. i datës 20.06.2017 dhe dëshmitarëve Sh. U. e Sh. K. të datës 20.06.2017 dhe mbrojtjen e të akuzuarit.

Dëshmitari Sh. U. në shqyrtim gjyqësor ndër të tjera ka theksuar se ditën kur ka shkuar E. S. për ta zbatuar urdhër arrestin e gjykatës unë kam shkuar në Prizren pasi që kam pasur ftesë nga nënkoloneli M. K. i cili ka kërkuar një raport nga unë dhe se në Drejtorinë e Policisë në Prizren kam qëndruar rreth një orë duke marr parasysht dhe dy orë rrugë vajtje ardhje. Kam biseduar me E. S. në telefon dhe se bisedën e parë e di që e kam bërë dhe kam qenë në

dalje të Dragashit për në Prizren ndërsa E. S. ka qenë në vend të ngjarjes në shtëpinë personit të kërkuar në fshatin B. dhe gjatë bisedës me të më ka thënë se situata është në kontroll dhe se nuk ka diçka të veçantë dhe aty ka përfunduar biseda. Pas një kohe kam tentuar që të bisedoj sërish me të, nuk kam mundur pasi që telefoni nuk ka pasur valë gjatë rrugës i kam parë patrullat policore që ishin në shtëpinë e personit të kërkuar duke u kthyer në drejtim të Dragashit i kam sinjalizuar dhe patrulla është ndalur edhe disa policë i kam pyetur se ku është personi i kërkuar policët më than se fol me togerin E. S. atëherë i jam drejtuar E. S. dhe e kam pyetur se ku është personi i kërkuar atëherë ai më ka njoftuar se personi i kërkuar ka ikur dhe nga ky moment kam qenë në kontakt të vazhdueshëm me E. dhe drejtorinë e policisë dhe kam kërkuar që të mirën të gjitha masat për sigurimin e vendit të ngjarjes dhe të aktivizohet plani operativë i policisë i cili është unaza e çeliktë ky plan aktivizohet kur personat e armatosur dhe të rrezikshëm janë në liri. Informatën nga E. e kam pasur se personi i kërkuar ka nxjerrë armën dhe nën kërcënim të armës ka ikur dhe gjatë bisedës me E. dhe drejtorinë policisë atëherë me një ekip të reagimit të shpejt kemi shkuar në shtëpinë e personit të kërkuar e kemi bërë bastisjen e shtëpisë dhe kërkimin e personit. Në policinë Kosovës punoj qe 16 vite dhe se ne gjithmonë kemi zbatuar urdhëresat e gjykatës dhe kemi pas kontakte të vazhdueshme me gjyqtarët dhe kryetarin e gjykatës. Secili stacion policor ka e ka të përgatitur planin për realizimin e urdhëresave është procedura e standardit të operimit për urdhëresa, ku policia i shfrytëzon ato më mirë por gjatë planit të arrestimit shfaqen edhe vështirësi dhe kemi ndonjëherë situata të pa parashikueshme që mund të hasim në vend të ngjarjes, kjo mund të ndodh të përgatitjes profesionale dhe jo profesionale edhe të zyrtarëve tjerë policor. Gjatë arrestimit paraprakisht njoftohet personi i kërkuar se a është i ndjekur nga gjykata, i prezantohet urdhëresa e gjykatës, i tregohen arsyet e arrestimit dhe pastaj arrestohet. Zakonisht në këto raste bisedat janë të shkurta dhe menjëherë veprohet. Nga informatat që i kam nga Sh. K. si përgjegjës për zbatimin e urdhëresave tek ky person disa herë kanë qenë policia në shtëpi për ta kërkuar por nuk kanë hasur tek personi i kërkuar, por sa herë konkretisht kanë shkuar për ta kërkuar këtë person janë raportet të cilët janë përpiluar. Atë ditë kemi pasur informata se personi i kërkuar gjendet në shtëpi dhe unë kam organizuar që të shkohet dhe të kërkohet, e kam thirr E. dhe kam kërkuar nga ai që të shkojë ta zbatojë urdhër arrestin dhe të gjithë zyrtarët kanë qenë të njoftuar për këtë urdhër arrest, por E. ka qenë me gradë më të lartë dhe kam kërkuar nga ai që të shkojë dhe ti mbikëqyrë zyrtarët tjerë pasi që ka qenë staf komandues.

Duke analizuar dëshminë e dëshmitarit Sh. U., gjykata vlerëson se i akuzuari E. S. është urdhëruar po atë ditë ad hoc që ti mbikëqyr njësit policore për ekzekutimin e urdhër arrestit të kësaj lidhur me arrestimin e personit të kërkuar M. Q. I cila ka zbatuar urdhrin e komandantit dhe së bashku me zyrtarët policor ka shkuar në shtëpinë e personit të kërkuar. Nga grada që e ka qenë i obliguar që personit të kërkuar t'ia prezantojë urdhrin dhe ta njoftojë lidhur me arrestimin e tij. Nga dëshmia e dëshmitarit nuk vërtetohet asnjë element i veprës penale për të cilën ngarkohet i akuzuari. Në asnjë rast nuk është përmendur se i akuzuari E. S. ka përfituar ndonjë të mirë materiale për vete apo për dikën tjetër ose ti ketë shkaktuar dëm ndokujt apo ti ketë tejkalluar kompetencat e veta. Të gjitha veprimet që i ka ndërmarr kanë qenë në përputhje me detyrat e tij zyrtare.

Dëshmitari Sh. K., në shqyrtim gjyqësor ndër të tjera ka theksuar se që nga viti 2000 punon në policinë e Kosovës dhe se ditën kur është zhvilluar aksioni policor në krye me të akuzuarin E. S. kam qenë në pushim dhe jam ftuar nga ana e komandantit Sh. U. që të përpiloj raport. Që nga viti 2012 unë e kam marr detyrën e menaxhimit të urdhëresave të gjykatës. Ne e kemi procedurën standarde operative e cila është në fuqi që nga viti 2010 dhe ne veprimet sipas asaj procedure, varësisht nga urdhri nëse kanë urdhra për kundërvajtje për pagesë,

atëherë zakonisht personat i dërgojmë deri në gjykatë dhe me pagesën e dënimit dhe vërtetimit nga ana e gjykatës se është përmbushur urdhëresa të njëjtit i kemi liruar pastaj kemi urdhëresat ditore ku personat e caktuar duhet të sillen në gjykatë dhe urdhrat tjera për shumta me të mëdha të hollave apo për arrestim ne i quajmë urdhra komunale ose urdhëresa, varësisht se çka kërkohet sipas urdhrit ne kemi vepruar ashtu ose kemi dërguar në burg krejt kjo varet se çka kërkohet me atë urdhër. Ka pasur raste kur personi i kërkuar ka kundërshtuar dhe pse kjo ka ndodhur rrallë, ne si stacion policor nuk kemi edhe numër të madh të urdhëresave, nëse një person të caktuar e kemi hasur në shtëpi apo gjatë ndonjë kontrole në komunikacion apo edhe sipas informatave se ku gjendet personi i caktuar ne kemi shkuar dhe e kemi arrestuar duke vepruar sipas urdhëresës. Gjatë arrestimit ne jemi të obliguar që të prezantohemi t'ia prezantojmë urdhrin e gjykatës t'ia sqarojmë detajet lidhur me arrestimin atëherë varësisht nga sjellja e tij ne dhe i ndërmarrin masat e parapara. Gjatë punës time kam pasur rast ta arrestoj një person me çrregullime mendore me veti kam marr dy patrulla të policisë dhe e kemi bindur duke biseduar rreth dy orë, pasi që personi ka qenë i rrezikshëm dhe me thikë dhe ka kërcënuar edhe persona tjerë me të kemi biseduar rreth dy orë dera sa është pajtuar që të dorëzohet dhe është arrestuar. Sa më kujtohet personi i kërkuar M. Q. ka qenë i kërkuar nga data 07.03.2017 dhe po atë ditë e kemi kërkuar dhe se për çdo veprim është përpiluar edhe raport me shkrim dhe për këtë person janë diku rreth 7 raporte të shkruara që është kërkuar dhe sipas këtyre raporteve të policëve nga terreni kryesisht kanë raportuar që i kërkuari gjendet në R të Serbisë raportet bazohen nga anëtarët e familjes së personit të kërkuar. Në praktik nuk bëjmë plan operativë për arrestimin e personave të kërkuar por nëse ka informata se personi i kërkuar mund të rezistoj duhet të bëjmë plan operativë dhe taktik, për rastin konkret nuk kemi patur ndonjë plan operativë por e kemi pas informata se ky person merret me drogë dhe se ka sulmuar një policë dhe ka ikur nga stacioni policor në Prizren. Nëse ka informata se personi është i rrezikshëm duhet të plani operativë dhe taktikë.

Duke analizuar dëshminë e dëshmitarit Sh. K., gjykata ka vlerësuar se përveç që ky dëshmitar ka treguar rrjedhën e procedurës së ekzekutimit të urdhër arrësit asgjë tjetër. Ditën kritike ka qenë në pushim dhe se është ftuar nga komandanti Sh. U. që të përpilohet raport me shkrim. Nga dëgjimi i këtij dëshmitari nuk është vërtetuar asnjë element i veprës penale për të cilën ngarkohet i akuzuari. Gjatë përshkrimit të procedurës lidhur me ekzekutimin e urdhër arrestit, i akuzuari ka vepruar në harmoni me obligimet që i ka pasur lidhur me ekzekutimin e urdhër arrestit dhe se marr parasysh gjendjen në terren mund të ketë situata të pa këndshme, ku dëshmitari thekson se ka pasur raste deri në “ dy orë ka negociuar me personin e rrezikshëm” me të vetmin qëllim mos të ketë pasoja në njerëz.

Dëshmitari I. I., në prokurori dhe në shqyrtim gjyqësor ndër të tjera ka theksuar se nga janari i vitit 2014 e deri me 01.11.2016 sipas planit operativ të stacionit kam punuar në zbatimin e urdhëresave dhe nga praktika askund nuk shkruhet se brenda cilit afat duhet të zbatohet urdhëresa përkatëse, por varësisht nga rrethanat pas pranimit të urdhëresës bëhet përpjekje për me zbatuar të njëjtën, mirëpo nëse personi ndaj të cilit zbatohet urdhëresa nuk është i kapshëm ne me memo zyrtare e njoftojmë gjykatën respektivisht prokurorin për pamundësinë e realizimit të urdhëresës përkatësisht për masat tona që i kemi marrë si polici në zbatim të urdhëresës po ashtu me këtë memo njoftohen eprorët tanë më saktë paraprakisht me memon njoftohen eprorët tanë, nënshkruhet nga eprorët e pastaj vuloset nga komandanti i stacionit dhe i dërgohet gjyqtarit apo prokurorit që e ka lëshuar urdhëresën. Deri sa unë kam punuar në zbatimin e urdhëresave asnjëherë nuk kam pasur ndonjë rast që me urdhër të eprorit apo komandantit të stacionit të jetë kërkuar shtyrja e zbatimit të ndonjë

urdhërese. Ditën kritike kam qenë pjesëmarrës në zbatimin e këtij aksioni të kapjes së personit në fjalë dhe më saktë kam qenë i caktuar nga togeri E. S. me qenë në oborr të të dënuarit. Pasi që është tendosur situata, kur i dënuari M. Q. nuk i bindej kërkesës së togerit, për lëshimin e armës dhe meqë në vend ngjarje përpos neve ishin edhe anëtarët e ngushtë të familjes të të dënuarit me qëllim të qetësimit të gjendjes dhe shmangies së ndonjë rrezikut eventual për jetë nga të dy palët, me urdhër të udhëheqësit të aksionit – togerit E. S. është zbritur shkalla e gatishmërisë dhe na është kërkuar që ta lëshojmë oborritin. Pas bisedës që ka bërë togeri me të na tha se i dënuari M. Q. është larguar prej oborrit dhe paska hyrë në një objekt përcjellës të shtëpisë e jo në shtëpi prandaj ne e kemi bërë bastisjen në objektin përcjellës e jo në shtëpi. Tek i dënuari ka qenë hera e parë që unë personalisht kam marrë pjesë në këtë zbatim të urdhër arrësit, për këtë rast jam njoftuar ditën kritike se duhet të shkojmë në fshatin B. që të zbatohet urdhër arresti, ky urdhër është dhënë nga komandanti i stacionit Sh. U., dhe deri në momentin kur jemi nisur kam menduar se do të jetë me ne komandanti stacionit Sh. U. por në momentin që jemi nisur e kamë parë togerin E. S. Togeri E. S. ka hyrë në oborr të personit të kërkuar ku ka biseduar me bashkëshorten e tij dhe me pas ka dalur nga shtëpia personi i kërkuar. M. Q. pas bisedës që ka pasur me togerin iu është drejtuar kolegut B. K. me fjalët “ se kush të ka thënë ty të hysh në oborr”, dhe e ka kapur për këmishe dhe e ka shtyrë kah dera e oborrit, në atë momente jam nisur në drejtim të e personit të dënuar dhe kam dashur që ta arrestoj, momentin që jam ofruar me kap krahun e tije ai është tërhequr mbrapa dhe nga mbrapa shpine ka nxjerrë një revole të cilën e ka bërë gati “repetir”, dhe e ka mbajtur në pozitë të ulur kah toka, të gjithë që kemi qenë aty i kemi nxjerr armët dhe i kemi drejtuar kah personi i kërkuar, armët tona kanë qenë të gatshme, të gjithë familjarët e personit të kërkuar e kanë rrethakuar M. dhe iu janë lutur atij dhe djali i tij ka bërtitur me të madhe “ babi të lutem mos “, në atë momente togeri ka urdhëruar që ta ulim gatishmërinë, ka biseduar me personin e kërkuar me pas ka urdhëruar ne të dalim jashtë, ne kemi vepruar ashtu, unë personalisht për një kohë të gjatë e kamë përcjellë në mënyrë vizuele togerin duke biseduar me personin e kërkuar dhe kjo bisedë ka zgjatur rreth 30 minuta, pastaj ka dalur togeri dhe na ka thënë se me duket se iki, ne jemi shpërndare duke e kërkuar në rrugën dytësore kah ka qenë dera tjetër, në shtëpi brenda nuk e kemi kërkuar pas 10 minutave kemi marrë urdhër dhe jemi kthyer në stacionin policor.

Duke analizuar dëshminë e dëshmitarit I. I., gjykata vlerëson se në tërësi rrjedha e situatës është shpjeguar pasi që ky dëshmitar ka qenë brenda në oborr të shtëpisë të personit të kërkuar dhe pas bisedës është zhvilluar në momentin e arrestimit është tensionuar situata dhe personi ka nxjerr armën dhe ky dëshmitar dhe dëshmitarët tjerë janë larguar nga oborri me urdhër të akuzuarit. Nga kjo dëshmi rrjedh se i akuzuari ka vepruar në pajtim me detyrat e tij për hir të situatës dhe të njerëzve të pa fajshëm që kanë mundur të pësojnë në këtë rast. Situata ka qenë e pa parashikuar dhe se nuk është pritur se personi i kërkuar do të rezistojë në këtë formë. Gjatë gjithë kohës në mënyrë vizuele e ka përcjellë bisedën që është bërë në mes të akuzuarit dhe personit të kërkuar por nuk ka dëgjuar atë bisedë. Nga kjo dëshmi nuk vërtetohet asnjë element i veprës penale për të cilën ngarkohet i akuzuari dhe se kjo dëshmi përkon me dëshmitë e dëshmitarëve tjerë si dhe me mbrojtjen e të akuzuarit.

Dëshmitari S. S. në prokurori dhe në shqyrtim gjyqësor ndër të tjera ka theksuar se ditën kritike kam qenë vetëm si vëzhgues, në mes të dy rrugëve kryesore ndërsa i akuzuari E. S. me personin e kërkuar kanë qenë rreth 50 metra larg meje. Gjatë bisedës që bënte togeri me personin e kërkuar M. Q., përmes telefonit e kam njoftuar komandantin policor të Dragashit Sh. U. se diçka nuk është në rregullt me zbatimin e aksionit, kam kërkuar nga ai që të dërgoj përforcime pastaj se çka ka ndodhur nga komandanti nuk e di, por e di që pasi jam njoftuar

prej togerit se paska ikur i dënuari M., nuk e di se a është bërë ndonjë bastisje pasi që unë kam qëlluar rreth 50 metra larg tyre, dhe me urdhrin e tij jemi kthyer në stacionin policor në Dragash, unë se bashku me kolegët tjerë kemi qenë të detyruar që ti nënshtrohemi urdhrin të zëvendës komandantit E. S. për me u tërhequr në bazë. Gjatë takimeve të mëngjesit nuk kamë dëgjuar asnjëherë se ndokush prej udhëheqësve tanë ka dhënë ndonjë urdhëresë qoftë me shkrim ose me gojë për shtyrjen e zbatimit të urdhëresës së gjykatës dhe arrestimit të dënuarit M. Q., mirëpo prej kolegëve por saktë nuk me kujtohet se prej kujt kamë dëgjuar që dikush prej udhëheqësve policor të stacionit paska marrë vendim që për një kohë të shkurtë të i shtyhet kapja e të dënuarit M. me pretekst se ai e paska pas të sëmur babain e tij. Nuk e di se si punohet me urdhëresa sepse unë merrem me një punë tjetër dhe nuk jam në gjendje të sqarohem për afatin e zbatimit pasi që me ato merret koordinatori i sektorëve togeri Sh. K. Por e di dhe kemi pas informata se M. Q. është person me rrezikshmëri dhe për këto informata kanë qenë të njoftuar eprorët dhe intelijenca e Prizrenit, për atë ditë nuk kemi pasur informatë se M. Q. gjendet në shtëpi dhe se atë ditë ka dhënë urdhër që të shkojmë në shtëpinë e tij komandanti Sh. U.

Duke analizuar dëshminë e dëshmitarit S. S., gjykata vlerëson se ky dëshmitarë ka qenë rreth 50 metra nga vendi i ngjarjes dhe se nuk ka qenë në dijeni se çfarë po ndodh por ndërkohë ka vërejtur se diçka nuk është në rregull, atëherë përmes telefonit ka kontaktuar me komandantin e stacionit policor Sh. U. të cilin e ka informuar se diçka situata nuk është e mirë dhe nga i njëjti ka kërkuar që të bie përforsime. Nga kjo dëshmi vërtetohet fakti se i akuzuari E. S. nuk ka qenë në plan që të merr pjesë në këtë zbatim të urdhër arrestit por nga i akuzuari ka kuptuar se me urdhër të komandantit është urdhëruar që të merr pjesë në zbatimin e këtij urdhër arresti. Edhe nga kjo dëshmi nuk është vërtetuar asnjë element i veprës penale për të cilën ngarkohet i akuzuari.

Dëshmitari N. Q., në prokurori dhe në shqyrtim gjyqësor ndër të tjera ka theksuar se ditën kritike kam qenë si pjesëmarrës dhe sipas urdhrin të udhëheqësit të aksionit e kam pasur rolin për me siguruar perimetrin e jashtëm të shtëpisë të të dënuarit dhe me i siguruar veturat zyrtare. Mbi gjysme ore ka zgjatur biseda në mes të akuzuarit E. S. dhe personit të kërkuar M. Q. Pas marrjes së informatës se personi i kërkuar M. Q. ka ikur, të gjithë pjesëmarrësit në aksion e kemi kontrolluar perimetrin jashtëm, unë konkretisht e kamë kontrolluar rrugën kurse koleget tjerë kanë dalur edhe pas shtëpisë së të dënuarit, te plema (ahëri), kurse unë konkretisht nuk kam parë se ndonjë policë ka hyrë që ta kontrollon shtëpinë brenda, ndërsa oborrit dhe pjesët përcjellëse të oborrit po. Kam realizuar disa urdhëresa të gjykatës ndaj personave të pa rrezikshëm, ky ka qenë personi i parë me rrezikshmëri pakë me të lartë. Ndërsa kur bëhet fjalë me persona me rrezikshmëri të lartë me planë operative veprohet e di që personit të kërkuar i lexohet urdhëresa dhe veprohet, e di që për këtë rast nuk ka pasur planë operative.

Duke analizuar dëshminë e dëshmitarit N. Q., gjykata vlerëson se ky dëshmitar ka qenë në perimetrin e jashtëm nuk ka dëgjuar bisedat që janë bërë brenda në mes të akuzuarit dhe personit të kërkuar. Nga kjo dëshmi është vërtetuar fakti se personi i kërkuar pasi që ka ikur është kërkuar në pjesën e jashtme të oborrit. Nga kjo dëshmi nuk vërtetohet asnjë element i veprës penale për të cilën ngarkohet i akuzuari.

Dëshmitari H. S., në prokurori dhe në shqyrtim gjyqësor ndër të tjera ka theksuar se varësisht prej situatës dhe rrethanave ne si stacion policor jemi te obliguar me e zbatuar çdo lloj të vendimit të gjykatës që ka të bëjë me arrestim të personave të caktuar, në rast të mos zbatimit të vendimit të gjykatës, jemi të obliguar që eprorëve tanë tua raportojmë për mos

mundësinë e zbatimit të urdhëresës apo të urdhër arrestit të lëshuar nga gjykata. Ditën kritike unë kam qenë në ndërrim dhe nuk kam marrur pjesë në aksionin për kapjen e personit të kërkuar M. Q. E di se disa herë kam qenë në shtëpinë e personit të kërkuar M. Q. dhe se nuk kemi mundur ta zbatojmë këtë urdhëresë pasi që bashkëshortja e tij na ka thënë se M. është larguar nga shtëpia dhe nuk e di se ku është, dhe se saktë me kujtohet se unë personalisht kam qenë rreth tri herë.

Duke analizuar dëshminë e dëshmitarit H. S., gjykata vlerëson se ky dëshmitar ka treguar procedurën e zbatimit të urdhëresave dhe se ditën kritike nuk ka qenë në detyrë dhe se nuk ka marr pjesë lidhur me zbatimin e urdhër arrestit për personin e kërkuar M. Q. Nga kjo dëshmi vërtetohet fakti se M. Q. ka qenë në listën e personave të kërkuar dhe se nga ky dëshmitar ka qenë në shtëpinë e tij rreth tri herë për ta kërkuar për këtë ka përpiluar edhe raporte me shkrim, dhe nga informatat që ka marr nga familjarët e personit të kërkuar se gjendet në r të Serbisë. Me këtë dëshmi nuk është vërtetuar asnjë element i veprës penale penale për të cilën ngarkohet i akuzuari.

Dëshmitari L. B., në prokurori dhe në shqyrtim gjyqësor ndër të tjera ka theksuar se dikund në muajin mars 2017, përmes telefonit toger Sh. K. me ka lajmëruar që të mos zbatohet urdhër arresti ndaj M. Q. se ka afat ligjor përkatësisht urdhër arresti sapo ishte lëshuar dhe se M. Q. e paska babain e tij në spital dhe se për 3-4 ditë nuk është e domosdoshme që ta arrestojmë. Këto fjalë nuk mi ka thënë në formë urdhri por thjeshtë në formë të bisedës. Në atë kohë unë kam qenë i interesuar e as që kam qenë në dijeni ta marrë atë lloj vendimi, tek me vonë në fund të muajit maj apo fillimi i muajit qershor 2017 është kuptuar që ky vendim qenka marrur së bashku me komandantin dhe zëvendës komandantin e stacionit policor në Dragash. Ditën kritike unë personalisht nuk kam marrë pjesë në zbatimin e urdhëresës për personin e kërkuar M. Q.

Duke analizuar dëshminë e dëshmitarit L. B., gjykata vlerëson se ky dëshmitar ditën kritike nuk ka qenë pjesë marrës në aksion lidhur me arrestimin e personit të kërkuar. Nga kjo dëshmi vërtetohet fakti se gjatë bisedës që ka pasur me togerin Sh. K. në muajin mars të vitit 2017 i cili i ka lajmëruar për 3-4 ditë mos të zbatohet urdhër arresti për personin e kërkuar M. Q. pasi që e ka babën të sëmur në spital. Nga kjo dëshmi nuk është vërtetuar asnjë element i veprës penale për të cilën ngarkohet i akuzuari.

Dëshmitari Q. S., në prokurori dhe në shqyrtim gjyqësor ndër të tjera ka theksuar se unë kam qenë në perimetrin e dytë para derës së oborrit të të dënuarit M. Q. kur e kam dëgjuar zëvendës komandantin që i thoshte policëve që ishin në oborr që të dalin nga oborri, se gjithçka do të bëhet mirë, bile i thoshte M. që të qetësohet, mos ndërmerr veprime të paligjshme, pastaj policët që ishin në oborr kanë dalur jashtë oborrit ku ishim ne policët tjerë në perimetër të jashtëm dhe të gjithë kemi qëndruar në pritje rreth gjysme ore të marrjes së vendimit përkatësisht urdhrit tjetër nga zëvendës komandanti E. S. Pas bisedës që kishte zhvilluar E. S. me personin e kërkuar, ka dalur dhe në gjuhën gorane na tregoj se personi i kërkuar e kishte prerë në besë dhe i paska ikur. Pas këtyre fjalëve të togerit ne e kemi kontrolluar perimetrin e jashtëm të rrugës dhe objektin përcjellës dhe se pasi që nuk ishte aty, ne jemi kthyer në stacionin policor në Dragash dhe që të përgatitemi për veprimet tjera. Togerit E. S. na informoj se pas bisedës që ka pas me personin e kërkuar i njëjti i ka thënë që hynë brenda në shtëpi ti merr rrobat dhe se do të vije me ne, dhe në ato momente ka ikur.

Duke analizuar dëshminë e dëshmitarit Q. S., gjykata vlerëson se dëshmitari ka qenë në perimetrin e jashtëm respektivisht para dyerve të oborrit, pas tensionimit të situatës i ka dëgjuar fjalët e të akuzuarit kur i ka urdhëruar policët të cilët kanë qenë oborr që të dalin jashtë duke iu thënë “se gjithçka do të bëhet mirë” dhe se të gjithë kanë qenë në pritje të ndonjë vendimi nga i akuzuari. I akuzuari ka biseduar me personin e kërkuar dhe në momentin kur ka dalur jashtë i akuzuari në gjuhen gorane na ka informuar se personi i kërkuar me preu në besë dhe iku, pas kësaj e kanë kontrolluar perimetrin e jashtëm të shtëpisë dhe pjesët përcjellëse të shtëpisë dhe se personi i kërkuar nuk ishte aty. Nga kjo dëshmi nuk vërtetohet asnjë element i veprës penale për të cilën ngarkohet i akuzuari.

Dëshmitari B. K., në prokurori dhe në shqyrtim gjyqësor ndër të tjera ka theksuar se në kontekst të situatës së rrezikshme të krijuar, ka qenë arsyeja e urdhrit të togerit E. me u larguar nga oborri i M. Ditën kritike kemi vepruar në bazë të urdhrit të togerit E. S., i cili në bazë të planit operativ dhe strategjisë së atij plani ka vlerësuar se çfarë urdhri ka dhënë ne si polic kemi vepruar konform këtyre urdhrave. Konsideroj se në aspekt moral, në kontekst të rrethanave të situatës, për shkak të rrezikut eprori në këtë rast togeri E. S. ka vepruar në përputhje me etikën profesionale. Ditën kritike kam qenë në afërsi të personit të kërkuar, i njëjti si me ka parë me ka kapur tek shpatulla me ka tërhequr dhe në atë momente nga mbrapa ka nxjerrë revolen, revolja e tij ka qenë e drejtuar nga toka. Kjo ngjarje ka ndodhur në momentin që kemi tentuar me arrestua personin e kërkuar ai e ka nxjerrë armën nga mbrapa shpine e ka repertuar, ka filluar me bërtit ne si zyrtar policor i kemi nxjerrë armët ka qenë punës sekondash kur kanë hyrë në mes nëna, bashkëshortja, dhe djali i të kërkuarit, ka qenë pamje e pa qartë pasi që edhe të kishim vepruar ne ka mundur të pësoj edhe ndonjë person tjetër. Ne paraprakisht nuk e kemi ditë që i kërkuari posedon armë me vete dhe sikur ta kishim ditë sigurisht kishim me vepruar ndryshe, në momentin që kemi tentuar që ta bëjmë arrestimin personi është larguar ka krijuar distancë dhe ka nxjerrë armën. Fillimisht unë veprimin për arrestim e kam filluar kur e kam parë që dy koleg tjetër veç kanë filluar që të veprojnë në drejtim të arrestimit, njeri prej kolegeve polici I. I., ka arrit për pak qaste që ta kap në dorë personin e kërkuar por ai e ka tërhequr dorën me shpejtësi, është tërhequr dhe e ka nxjerrë armën. Personi para se ta nxjerrë armën, kemi qenë në afërsi dhe se personi i kërkuar ndaj meje ka patur një revolt, për arsye pse isha i vendosur me thellë në oborrin e shtëpisë dhe fillimisht ka filluar me bërtit ne drejtim timin në gjuhen boshnjake, pastaj ka vazhduar edhe në gjuhën shqipe në momentin kur jam ofruar më afër ku ishin duke qëndruar tre koleg tjerë dhe personi në kërkim është vërsulur në drejtim timin si që tregova edhe me lartë me ka kapur në krah – supe dhe me ka thënë hajde me dalë jashtë, në ato momente ia kam larguar dorën e kam shtyrë pak dhe në ato qaste ka intervenuar edhe kolegu I. dhe në ato momente e ka nxjerrë armën. Këto kanë qenë arsyet pse ne nuk kemi mundur që ta arrestojmë. Planë operativë të shkruar nuk kemi pasur por plani ka qenë çka ka arritur rrugës me përpiluar togeri E. S. dhe se ky i fundit iu është bashkangjitur grupit, se edhe ky vetë nuk e ka ditur se do të jetë pjesë për arrestimin e personit të kërkuar. Pasi kemi mbërrir në stacion togeri E. S. me ka urdhëruar që se bashku me një koleg të kthehem tek vendi i ngjarjes dhe ne jemi kthyer dhe kemi qëndruar aty deri sa kanë ardhur njësit tjera dhe është bërë bastisja.

Duke analizuar dëshminë e dëshmitarit B. K., gjykata vlerëson se ky dëshmitar ka qenë prezent në oborr të shtëpisë së personit të kërkuar dhe me vetë faktin se personi i kërkuar e ka parë këtë dëshmitarë në thellësi të oborrit e ka kapur për supe që ta largon në atë moment ky dëshmitar ka tentuar që ta arreston atëherë personi i kërkuar është tërhequr mbrapa dhe mbrapa shpinës ka nxjerrë armën. Nga kjo dëshmi vërtetohet fakti se të gjithë zyrtarët policor kanë nxjerr armët në drejtim të personit të kërkuar atëherë kanë ndërhy familjarët e personit

të kërkuar nëna, bashkëshortja dhe djali i tij duke e rrethakuar që mos ndoshta do të sulmohet nga zyrtarët policor atëherë në këtë situatë personi i kërkuar ka kërkuar nga i akuzuari që të dalin janë zyrtarët policor dhe që të bisedojnë me të akuzuarin lidhur me dorëzimin. Pas kësaj situatë i akuzuari urdhëron zyrtarët policor që të dalin jashtë dhe gjatë bisedës personi i kërkuar e ka vu në lajthim të akuzuarin që kinse po hin që të merr rrobat dhe në atë moment nga dera mbrapa shtëpisë edhe ka ikur. Nga kjo dëshmi vërtetohet fakti se i akuzuari ka vepruar në mënyrën më të mirë që mos të vie situatë që të pëson ndonjë person i pa fajshëm. Kjo dëshmi është në përputhje edhe me deklaratat e dëshmitarëve të cilët kanë qenë në oborr edhe me mbrojtjen e të akuzuarit.

Dëshmitari I. H., në prokurori dhe në shqyrtim gjyqësor ndër të tjera ka theksuar se ne kemi qenë në rrugë para derës së oborrit të shtëpisë së të kërkuarit M. Q., kur ka ardhur togeri E. S. i cili kishte biseduar rreth gjysme ore me të dënuarin për ta bindur për me u dorëzua, kur ka dalur na ka informuar se qenka mashtruar prej M. se ai paska ikur e për çka me urdhër të E. jemi shpërndare për me kërkuar rreth shtëpisë apo rrugicave por nuk kemi mundur ta gjejmë. Një kohë të shkurtër kemi qëndruar para shtëpisë së M. andaj togeri ka marrë vendim që të kthehem për në Dragash. Nuk kemi pasur urdhër që ta bastisim shtëpinë e M. Detyra ime ka qenë si policë kontaktues të bisedojmë me personat të cilët paraqiten. Fillimisht kemi biseduar unë dhe togeri E. S. me bashkëshorten e personit të kërkuar e cila ka qenë e para që na është përgjigjur, na tha se M. nuk është në shtëpi, disa herë e njëjta deklaronte se nuk është M. në shtëpi, unë dhe togeri E. i kemi thënë që nëse thua ti se nuk është në shtëpi, ne kemi urdhër arrest të personit dhe do të hymë dhe ta kontrollojmë brenda në shtëpi, e njëjta nuk na ka thënë asgjë, u fut brenda në shtëpi pastaj ka dalur M. Kur ka dalur M. nga shtëpia u përshëndet, unë e kam pasur urdhër arrestin dhe i kam thënë se ke urdhër arrest dhe duhet të vish me ne, i njëjti nuk ka thënë as që vi e as nuk vi, atëherë kolegu B. ishte pak më brenda oborrit dhe M. iu drejtua B. me fjalët se kush jeni ju, kush të ka thënë të hysh këtu, dhe gjatë fjalosjes me B. ne kemi tentuar që ti afrohemi ta arrestojmë, M. është tërhequr mbrapa dhe nga mbrapa shpinës e ka nxjerrë revolen, aty kemi qenë unë, togeri E. polici I. I. dhe B. K. Në momentin kur e ka nxjerrë revolen edhe ne i kemi nxjerrë revolet, ka qenë një kohë që mund të them një minutë, dy herë e ka repetu revolen dhe në oborr kanë qenë edhe familjaret e tij, bashkëshortja, nëna dhe djali i tij, kur i kemi nxjerrë edhe ne armët është krijuar një distancë prej 10 - 15 metrave, kanë ndërhy familjaret e tij fillimisht djali i tij duke shkuar të M. duke e lutur “aman babi mos gjuaj, mos gjuani”, dhe kanë vazhduar para M. bashkëshortja, nëna dhe djali e tij, të cilin e kanë mbuluar që te mos gjuajmë ne. Në ndërkohe kemi marrë urdhër që të largohemi prej aty dhe jemi larguar jashtë. Pas bisedës që ka bërë togeri me personin e kërkuar dhe pas një kohe ka dalur jashtë dhe na ka informuar se personi i kërkuar ka ikur, ne kemi vazhduar që të kontrollojmë vendin ishte aty një aneks – stallë, kemi kërkuar edhe rreth shtëpisë, por nuk e kemi gjetur. Togerit na ka dhënë paraprakisht urdhra kush dhe ku të qëndrojmë. Ne jemi larguar pasi që personi i kërkuar i është drejtuar togerit dhe i ka thënë, nëse i largon këta jashtë unë bisedoj me ju ndryshe deri të vritemi nuk dorëzohemi.

Duke analizuar dëshminë e dëshmitarit I. H., gjykata vlerëson se edhe ky dëshmitar ka qenë në oborr duke e përshkruar situatën si të pa përshkueshme dhe se nuk e kanë pritur që personi i kërkuar posedon armë. Situata është tensionuar në atë moment kur personi i kërkuar kërkon nga dëshmitari B. K. që ta lëshon oborrin e tij dhe në momentin e arrestimit atëherë tërhiqet mbrapa dhe nga mbrapa shpinës nxjerr revolen, në atë moment të gjithë zyrtarët policor i drejtohen me armë ndërhynë djali i tij “o babi mos gjuaj, aman mos gjuani” atëherë para personit kërkuar dalin bashkëshortja, nëna dhe djali i tij duke e rrethakuar. Atëherë personi i kërkuar ka kërkuar nga i akuzuari që të largohen zyrtarët policor me qëllim

të bisedës me të akuzuarin lidhur me dorëzimin e tij, pas bisedës personi i kërkuar nga i akuzuari ka kërkuar që të hynë brenda që ti merr rrobat dhe se do të dorëzohet, nga dera mbrapa shtëpisë edhe ikë. Menjëherë i akuzuari me policët tjerë kanë kontrolluar perimetrin e jashtëm të shtëpisë dhe stallën ku është dyshuar se është fshehur po nuk është gjendur. Nga kjo dëshmi është vërtetuar fakti se i akuzuari ka vepruar në mënyrën më të mirë që mos të pëson ndonjë person i pa fajshëm. Nga kjo dëshmi nuk vërtetohet asnjë element i veprës penale për të cilën ngarkohet i akuzuari.

Dëshmitari M. Q., në prokurori dhe në shqyrtim gjyqësor ndër të tjera ka theksuar se policia për këtë çështje ka qenë disa herë në shtëpinë time por unë nuk kam qenë aty dhe për këto fakte me ka treguar bashkëshortja ime. Për arsyen se nuk kam shkuar në vuajtje të dënimit ka qenë arsyeja se kam pritur vendimin e gjykatës Supreme ku kishte bërë ankesë mbrojtësi im për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë dhe me qëllim ta siguroj familjen e pastaj të shkoj në vuajtje të dënimit. Problemin tim për të shkuar në vuajtje të dënimit disa herë e kamë diskutuar me shokun tim A. S., i cili po ashtu ka qenë në dijeni se babai im është i sëmur dhe nuk e di saktë por e di se kjo ka ndodhur para tre muajve, A. ka biseduar me ndonjë lokal apo ka shkuar drejtë për drejtë në stacioni policor në Dragash dhe ka biseduar, nuk e di saktë se me kënd por me siguri me udhëheq sat e stacionit policor në Dragash për mundësin që të me shtyhet për një dy ditë zbatimi i urdhër arrestit për me shkuar në vuajtje të dënimit dhe kjo ka ndodhë kështu që rreth një jave policia nuk me kanë kërkuar përkatësisht nuk kanë qenë te shtëpia për mem arrestuar. Ditën kritike rreth orës 11.30minuta në shtëpinë time ka ardhur një patrullë e policisë ku aty kishte qenë si udhëheqës E., kanë hyrë të dera e shtëpisë pra në oborre, se pari ka dalë bashkëshortja e cila me ka treguar se po me kërkojnë policia, kam dalur edhe unë, E. me ka treguar se e ka një urdhër arrest të gjykatës për me zbaruar dhe është e domosdoshme që të me dërgojnë në burg për një rast penal që më kishte ndodhur mua me herët, i kam thënë E. që për këtë çështje kamë bërë ankesë për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit në gjykatën supreme, ai me tha se kjo për ne nuk ka rëndësi, si polic duhet ta zbatojmë urdhër arrestin dhe duhesh me ardhë me ne në stacionin policor, unë atëherë në këtë situatë i thashë po i marrë rrobat në shtëpi dhe po vijë, pastaj kur kamë hyrë brenda kam përfituar nga rasti dhe kam ikur duke dalur prej derës tjetër ka nuk kishte polic, kam kaluar neper oborr ne një rrugë tjetër dhe jam fshehur afër shtëpisë në stallën time të lopëve. Nuk kam pasur armë me vete dhe se biseda me E. ka zgjatur 3-5 minuta, nuk kam pasur mosmarrëveshje me asnjë policë. E. S. njoh qysh me herët si njeri të mirë, ka punuar në një ish ndërmarrje bujqësore blegtorale, "Sh. P. " në Dragash, me të njëjtin nuk kam pasur kontakt asnjëherë kurse Sh. K. e njoh por nuk kam pasur ndonjë raport personal, ndërsa Sh. U. nuk e njoh fare. Nuk kemi patur kurrfarë marrëveshje me të akuzuarin E. S. Ditën kritike nuk kam nxjerrë armë as unë e as policia.

Duke analizuar dëshminë e dëshmitarit M. Q., gjykata vlerëson se ky dëshmitarë e ka përshkruar pjesë pjesë ngjarjen dhe i njëjti ka theksuar se ditën kritike nuk ka pasur armë dhe se e ka vu në lajthim të akuzuarin në atë moment kur i ka thënë se po hy që ti marr rrobat dhe ka ikur nga dera mbrapa ndërsa në pjesën tjetër kjo dëshmi është në kundërshtim me deklaratat e dëshmitarëve tjerë. Por megjithatë edhe nga kjo dëshmi nuk vërtetohet asnjë element i veprës penale për të cilën ngarkohet i akuzuari. Ngase ky dëshmitar e njeh të akuzuarin vetëm i zv. Komandant me të njëjtin nuk ka kurrfarë raporti dhe asnjëherë nuk ka biseduar me të përveç ditën kritike.

Dëshmitarja M. T., në shqyrtim gjyqësor ndër të tjera ka theksuar se M. Q. e ka bashkëshort, policia ka ardhë që ta kërkon M. disa herë po ashtu edhe me dt.01.06.2017, unë

kam dalur, M. ka qenë në gjumë e kam thirr M., ka dalur M. kanë kërkuar policia që M. të shkon me ta, M. ka treguar një letër që ka bërë kërkesë për me shty vuajtjen e dënimit dhe më shumë nuk di asgjë se çka kanë biseduar. Me kujtohet se ne fillim kanë qenë dy – tre polici pastaj M. ka kërkuar që të bisedoj vetëm me E. dhe se kanë biseduar vetëm këta të dy polic tjetër nuk ka pasur. M. ka thënë se do të dorëzohet vullnetarisht, ka hyrë brenda me i marrë teshat dhe nga hyrja tjetër ka dalur dhe ka shkuar në stallë-fermë, ndërsa E. e ka ditur që M. të i merr teshat. Në vendin ku ka qenë E. nuk ka mundur që ta vërejë se kah ka dalur M. pasi që dera tjerë ka qenë në kahje tjetër.

Duke analizuar dëshminë e dëshmitares M. T., gjykata vlerëson se kjo dëshmitare është përgatitur nga dëshmitari M. Q. çka të deklaron, ka mohuar në tërësi ngjarjen e cila ka ndodhur. Por nga kjo dëshmitare është vërtetuar fakti se M. ka hyrë kinse për ti marr rrobat dhe ka dalë nga dera e mbrapme dhe se vendi ku ka qenë i akuzuari nuk ka mundur të shihet pjesa e mbrapme se kah ka ikur personi kërkuar. Nga kjo dëshmi nuk vërtetohet asnjë element i veprës penale për të cilën ngarkohet i akuzuari.

Nga urdhër arresti i Gjykatë Themelore në Prizren PED.nr.48/17 të datës 02.03.2017, gjykata vlerëson se nuk është kontestues fakti se ndaj personit të kërkuar është lëshuar urdhër arrest për vuajtje të dënimit.

Nga raporti njoftues të MPB-IPK, Departamenti i hetimeve në Prishtinë, me numër të protokollit 03-116-1263/16 të datës 14.07.2017 - rezultati i raportit ligjorë të operatorit Vala, është vërtetuar fakti se nuk ka ndodhur asnjë bisedë telefonike nëpërmjet operatorit “vala” në mes të akuzuarit dhe personit të kërkuar nga muaji mars 2017 deri me datën 01.06.2017 nga numrat e telefonit 044-7..., 044-8... dhe numri 044-75... Me këtë provë nuk vërtetohet asnjë element i veprës penale me të cilën ngarkohet i akuzuari.

Nga raporti i bastisjes të Njësisë së forenzikës të DRP në Prizren numër TK-053-2017 të datës 05.06.2017, është vërtetuar fakti se gjatë bastisjes së shtëpisë së të akuzuarit nuk është gjetur asnjë provë inkriminuese lidhur me këtë rast dhe gjatë kësaj bastisje është sekuestruar telefoni pronë e të akuzuarit me nr. IMEI:8... Me këtë provë nuk vërtetohet asnjë element i veprës penale me të cilën ngarkohet i akuzuari

Nga raporti njoftues të MPB-IPK në Prishtinë me numër protokollit 02-116-1263/15 të datës 07.07.2017 mbi ekzaminimin e telefonave të sekuestruar me raportin e ekspertizës të telefonave dhe certifikatat mbi kthimin e telefonave të sekuestruara në pronësi të akuzuarit E. S. i datës 20.06.2017 dhe dëshmitarëve Sh. U. e Sh. K. të datës 20.06.2017, është vërtetuar se pas ekspertizës telefoni i sekuestruar nga i akuzuari nuk përmban asnjë veprim inkriminues lidhur me këtë rast.

I akuzuari E. S. në mbrojtjen e tij të dhënë në prokurori dhe në shqyrtimin gjyqësor ndër të tjerash ka theksuar se që nga viti 2000 punon si polic, fillimisht kam qenë policë në kontrole, pas marrjes së gradës së rreshterit kam qenë shef i njësitit patrullues dhe pas marrjes së gradës toger kam qenë shef i sektorit të operativës dhe kohëve të fundit e kryej detyrën e zëvendës komandantit të stacionit policor në Dragash. I ngarkuar për ekzekutimin e urdhëresave është koordinatori i sektorëve të sigurisë togeri Sh. K. Me sa di unë pasi që të na vjen urdhëresa e çfarëdo lloji natyre nga gjykata apo prokuroria, regjistrohet në librin gjegjësisht në regjistrin e pranimit të urdhëresave, pas regjistrimit punëtori administrativ e ngarkon shefin e sektorëve të sigurisë togerin Sh. K., kurse Sh. K. urdhëresën e gjykatës e evidenton në forme elektronike në listën e personave të kërkuar, pavarësisht çfarë natyre të

veprës personi i kërkuar. Pas evidentimit togeri K. e fotokopjon nga një ekzemplar të urdhëresës dhe e dorëzon varësisht se personi i kërkuar cilit sektor i takon, pastaj policët e atij sektori angazhohet rreth zbatimit të urdhër arrestit. Në rastin konkretë për urdhëresën e M. jam informuar menjëherë pas 1-2 dite, nga arritja e urdhër arrestit në Stacionin policor në Dragash. Nuk me kujtohet saktë data po e di se ka qenë ditë e Mërkurë ose e Enjte, me kishin ftuar disa persona në stacionin policor në Dragash, kam zbritur poshtë e kam pyetur kujdestarin se kush me ka ftuar kishin qenë dy persona, njërin e njohë e di që quhet A., kurse tjetrin nuk e njihja, për me vonë kam kuptuar se personi në fjalë po punon si vozitës në një kompani turistike "A. T.", jam përshëndetur me ta i kam pyetur se çka mund te ju ndihmoj pastaj ata kanë kërkuar që te ju ndihmoj, nëse ka mundësi me shty afatin e ekzekutimit të urdhër arrestit ndaj M. Q., kinse se ai e paska babain të sëmur, unë atyre ju kam thënë nuk mund të marr ndonjë vendim duhet të bisedoj me komandantin e stacionin policor në Dragash kapitenin Sh. U. u kam thënë që njeri prej tyre të me jep numrin e telefonit dhe varësisht nga vendimi i komandantit ata do ti njoftojë. Menjëherë kam shkuar në zyrën e komandantit Sh. U., aty kishte qenë prezent edhe togeri Sh. K., përndryshe është edhe i ngarkuar me zbatimin e urdhëresave, ia kam përcjellë komandantit kërkesën e qytetarëve përkitazi me rastin e M. Q., atëherë komandanti me ka pyetur se çfarë mendimi kam unë, dhe çfarë mendimi ka togeri Sh., unë i kam thënë se nuk kam çka me mëndu, ti je komandant e jotja është e fundit, kurse Sh. nuk ka komentuar fare, atëherë komandanti tha se ne edhe ashtu që dy muaj nuk po jemi në gjendje ta arrestojmë. I është drejtuar Sh. me fjalët "thuaji policëve në patrullë që mos e prekin disa ditë, t'ia ofrojmë mundësin pasi që e paska babain e tij në operacion në Prizren", e pastaj, si duket Sh. u ka thanë policëve nga sektori i tretë që mos të marrin masa ndaj M. lidhur me urdhër arrestin ndaj gjykatës. Për ditën kritike nuk e kam ditur që do të jem pjesëmarrës në zbatimin e këtij urdhër arrestit dhe se nuk kam qenë në dijeni për planin konkretë operativ taktik, për arrestimin e tij. Kur kemi shkuar tek shtëpia e tij iu kam dhënë instrukcionete policëve dhe pasi që ka dalur M. dhe deri sa unë kam zhvilluar bisedë me M. për me u dorëzuar policët kanë qenë jashtë oborrit konkretisht polici I. I., ka qenë para derës së oborrit në rrugën kryesore, dera ka qenë pakës e hapur dhe vizualisht ka mundur te me vërej mua duke biseduar me M., kurse anëtarët e familjes, konkretisht bashkëshortja e tij ka qenë pranë meje nëna e tij ka qenë diku në mes, ndërsa biri i tij i kishte kapur duart babait përkatësisht M. dhe nuk besoj se nga kjo distancë, polici ka mundur të dëgjoj bisedën tonë. Është e vështirë për së shpjeguar mirëpo duke i marrë parasysh rrethanat e ngjarjes në teren dhe kontestin e situatës, unë i besova M. për shkak të rrethanave, dhe duke e pritur që të del kam dëgjuar një britme në stallë të lopëve i thash bashkëshortes së tij se ai paska ikur, menjëherë me I. I. dhe dy policët tjerë kam shkuar në drejtim të stallës, e kam kontrolluar stallën në tërësi, pra edhe kulimin e stallës ku ishte sana apo kashta, dhe menjëherë kam shkuar ne drejtim të policëve në rrugë dhe për personin për te cilin kemi ardhur paska ikur, shtëpinë nuk e kam bastisur pasi që kam qenë i bindur se në shtëpi nuk është, nuk kam lenë asnjë patrullë policore, ky ka qenë gabimi im i pa qëllimshëm por si kam shkuar në stacionin policor kam urdhëruar që një patrullë policore të shkon në vend të ngjarjes që të qëndrojnë afër shtëpisë së tij. Me personin e kërkuar kam negociuar rreth 30-40 minuta që të dorëzohet me të vetmin qëllim që mos të ketë pasoja në njerëz dh e për këtë arsye edhe kam negociuar me te, dhe edhe sot po të isha në situatën të njëjtë do të veprojsa njëjtë vetëm që mos të ketë viktima në njerëz.

Duke analizuar mbrojtjen e të akuzuarit E. S., gjykata vlerëson se kjo mbrojtje është në harmoni me të gjitha provat siqë janë dëshmitë e dëshmitarëve dhe provat tjera materiale. I akuzuari e ka përshkruar në tërësi ngjarjen se si ka ndodhur dhe se ditën kritike ad hoc është caktuar nga komandanti stacionit policor në Dragash Sh. U. që ky të jetë mbikëqyrës i grupit

lidhur me ekzekutimin e urdhër arrestit të Gjykatës Themelore në Prizren dhe se nuk ka patur plan operativ por gjatë rrugës iu ka dhënë detyrat zyrtarëve policor. Të gjitha veprimet e të akuzuarit kanë qenë në harmoni me detyrat e tij zyrtare dhe se ditën kritike ka hasur në një situatë të pa pritshme dhe se informatat e tij kanë qenë të pakta se nuk ka qenë në dijeni se personi i kërkuar së pari të jetë në shtëpi, të jetë i armatosur apo të jetë person i rrezikshëm ngase për arrestimin e personave të rrezikshëm duhet të bëhet plani operativ dhe taktikë dhe të intervenoj njësia përkatëse. Edhe me mbrojtjen e të akuzuarit nuk është vërtetuar asnjë element i veprës penale për të cilën ngarkohet i akuzuari.

Bazuar në provat e administruara në shqyrtim gjyësor e të cilat janë elaboruar dhe vlerësuar me ndërgjegje në pajtim me nenin 361 parag. 2 të KPP-së. Organi i akuzës me asnjë provë nuk ka argumentuar - vërtetuar se cilat kanë qenë veprimet inkriminuese të të akuzuarit. Nga provat e administruara është vërtetuar se i akuzuari ditën kritike ad hoc është caktuar nga komandanti i stacionit që të mbikqyrë - udhëheqë patrolat policore lidhur me ekzekutimin e urdhër arrestit të Gjykatës Themelore në Prizren, por gjatë ekzekutimit të urdhër arrestit ka hasur në situatë të pa pritur gjë që asnjëri nga zyrtarët policor të cilët kanë qenë në vendin e ngjarjes nuk e kanë pritur këtë situatë që personi i kërkuar të jetë i armatosur, me daljen e personit të kërkuar asnjëri nga ta nuk ka vërtetuar ndonjë gjë të dyshimt por pas komunikimit se duhet të arrestohet është tensionuar situata dhe në ato momente personi i kërkuar pas fërkimit që ka pasur me zyrtarin policor B. K. edhe ka nxjerr armën ku të gjithë zyrtarët policor i janë përgjigjur njejtë por pas ndërhyrjes së familjarëve të personit të kërkuar atëherë ka ndryshuar edhe situata që mos të pësojë ndonjë person i pa fajshëm dhe e gjithë përgjegjësia ka ra tek i akuzuari i cili në atë situatë i ka tërhequr zyrtarët policor me qëllim të negociimit me personin e kërkuar dhe pas negociimit personi i kërkuar ka pranuar që të dorëzohet por në këtë çast e ka vu në lajthim të akuzuarin kinse do ti merr rrobat dhe nga dera e mbrapme e shpisë ka ikur, i akuzuari me të dëgjuar britmë tek stalla i informon zyrtarët policor se ka ikur dhe vetë i treti ka hy në stallë për ta kërkuar dhe zyrtarët tjerë policor duke e kërkuar në perimetrin e jashtëm të shtëpisë. Këto fakte më së miri i kanë vërtetuar dëshmitarët të cilët kanë qenë brenda oborrit të shtëpisë dhe jashtë oborrit të shtëpisë –në perimetrin e jashtëm, të cilët kanë theksuar se është krijuar një situatë tensionuese dhe se veprimi i të akuzuarit ka qenë më i miri i mundshëm që mos të pësojë ndonjë person i pa fajshëm. Po ashtu ky fakt është mbështetur edhe nga provat materiale të cilat janë administruar në shqyrtim gjyqësor dhe nga këto prova askund nuk vërtetohet se i akuzuari ka qenë në dijeni se do të jetë mbikqyrës i patrollave policore ose të ketë përpiluar plan operativ apo taktik siq kërkohet në këto raste kur kanë të bëjnë me persona me rrezikshmëri. Këto dëshmi të dëshmitarëve dhe provat materiale gjykata i ka marr si vendimtare në vendosjen e këtij aktgjykimi. Gjykata konstatoi dhe vërtetoi gjatë shqyrtimit gjyqësor se asnjë veprim që ka ndërmarë i akuzuari nuk përkon me gjendjen faktike për të cilën pretendon organi i akuzës. Së fundmi nga provat e administruara, gjykata vetëm sa e forcoi bindjen e saj se në veprimet e të akuzuarit E. S., nuk formohen elementet dhe tiparet e veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KP-së. Duke pasur parasysh se për ekzistimin e veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autorizimit zyrtar, për të cilën akuzohet i akuzuari duhet të ekzistojë qëllimi për të përfituar dobi pasurore në mënyrë të kundërligjshme për vete ose për tjetrin, apo për ti shkaktuar dëm tjetrit dhe gjykata gjatë administrimit të të gjitha provave, dëgjimit të dëshmitarëve nuk ka mund të vërtetojë qëllimin e të akuzuarit për kryerjen e kësaj vepre penale, që i njëjti duke shfrytëzuar autorizimet e tij, i ka tejkualuar kompetencat ose nuk i ka përmbushur detyrat zyrtare për të përfituar dobi pasurore të kundërligjshme. Së këndejmi, pas vlerësimit të provave materiale (provave të lart theksuara), dhe pas analizimit të secilës provë veç e veç

dhe të ndërlidhura në tërësi, dhe të gjitha së bashku, gjykata gjeti se nuk është vërtetuar se i akuzuari të ketë kryer veprën penale e cila i vihet në barrë për të cilën akuzohet nga ana e prokurorit të shtetit, respektivisht veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KP-së. Vepra penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPK-së, përcakton: "Personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që ti shkaktojë dëm personit tjetër ose që seriozisht ti shkel të drejtat e personit tjetër...". Pra, përgjegjësinë penale për këtë veprë penale një i akuzuar e ka nëse si person zyrtar e shfrytëzon detyrën apo autorizimet, me tejkalimin e kufijve të autorizimeve të tij me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër duke i shkaktuar dëm personit ose shkel seriozisht të drejtat e personit tjetër, e që në rastin konkret nuk është provuar një gjë e tillë. Ndërsa neni 22 i KP-së, përcakton se "dijenja, dashja, pakujdesia ose qëllimi i kërkuar si element i veprës penale mund të nxirret nga rrethana faktike", pra qëllimin e kryerjes së veprës penale nxirret nga provat dhe faktet e shtjelluara në një çështje penale.

Gjykata me provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor dhe vlerësimin e tyre veç e veç dhe në lidhje me provat tjera, ka ardhur në përfundim se nuk është provuar se i akuzuari në cilësinë e personit zyrtar duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar nuk e përmbush detyrën zyrtar të tij me qëllim që të përfitoj dobi personit tjetër, në atë mënyrë që me datën 01.06.2017, rreth orës 11:00, në fshatin ... – Komuna e Dragashit, duke udhëhequr patrullën policore në përbërje prej 9 zyrtarëve policor me mision zbatimin e urdhër arrestit të gjykatës themelore në Prizren PED.nr. 48/17 të datës 02.03.2017, për dërgim në vuajtje të dënimit me burgim të gjykuarit M. Q., me të njëjtin e bisedon çështjen e arrestimit të tij dhe kur i gjykuari hynë në shtëpi me pretekst që të përgatitet përfiton nga rasti për tu fshehur e pastaj në funksion të arrestimit të tij nuk e urdhëron patrullën për ta bastisur shtëpinë dhe objektet përcjellëse, përkundrazi pa lenë patrullë për ta vëzhguar shtëpinë e të gjykuarit e urdhëron ekipin policor për tu larguar nga vendi i ngjarjes.

Andaj duke u bazuar nga të lartcekurat dhe provat të cilat u administruan nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale që i vihet në barrë me aktakuzë, prandaj të njëjtin e liroi nga akuza.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 451 dhe 453 paragrafi 1 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN,
Departamenti i Krimeve të Rënda
PKR.nr.75/2017 më datë 26.01.2018**

**Procesmbajtësja
Florije Kolukaj**

**Kryetari i trupit gjykues
Artan Sejrani**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.